

Dr. Islam Dobra

KONFLIKTET ITALIANE ME TURQINË RRETH PROBLEMIT SHQIPTAR 1908-1913

Italia, rreth çështjes shqiptare, konfrontohet me Turqinë për dy synime: Së pari që të krijojë kushte për të depërtuar në Adriatikun lindor, në mënyrë që atë ta vëj nën ndikimin e vet dhe të krijojë mundësi për të dominuar në të ardhshmen mbi të¹, dhe së dyti, po qe se, ky i pari nuk realizohet, atëherë të angazhohet në planin diplomatik, përkatësisht që Shqipërisë t'i njihet autonomia të cilën e kërkonte që nga Lidhja e Prizrenit.² Turqia, me revolucionin Xhonturk nuk i arriti qëllimet dhe synimet e parashtruara në territoret shqiptare, të cilave mendohej t'ua diktojë vullnetin e vet. Këto rrethana bëjnë që marrëdhëniet sa vinin keqësoheshin edhe më shumë.³

Italia me dinakëri i shfrytëzonte rrethanat e krijuara në Turqi dhe rreth saj. Ky raport midis Italisë dhe Turqisë shkaktoi konfrontime. Ato u acaruan edhe më shumë për shkak të pretendimeve italiane në territoret turke në Ballkan, por më shumë edhe për propagandën që ajo zhvillonte në dobi të shteteve tjera e dëm të Turqisë.⁴ Ndaj Italia, për të ushtruar ndikimin e vet në tokat shqiptare, më shumë u angazhua në kohën kur zhvillohej Revolucioni Xhonturk dhe në kohën kur nga ana e Austro-Hungarisë u aneksua Bosna dhe Hercegovina. Shi për këtë kontradiktat midis Italisë dhe Turqisë u thelluan edhe më shumë.⁵ Ajo duke i shfrytëzuar rrethanat e rënda në Turqi ngriti përfaqësi ekonomike, posta e zyre dhe bënte tregti me qytetet shqiptare: Skodrën, Durrësin, Vlorën e të tjera.

¹Historia e popullit shqiptar. Vëllimi II, f.277

²Haus-Hoff und Staatsarchives Wien-Paris. 1913. p.340

³Po aty

⁴Pinon Réne, Leuopen et jeune Turqie et Albanien, Paris 1913, p.341

⁵F.crispi, Politica estera, Milano 1912, p.25-26

Në këtë kohë Turqia nuk mundi t'i kundërvihej asaj.⁶ Italia zgjeronte tregtinë e lundrimin, jepte koncesione për hapjen e rrugëve dhe për rregullimin e porteve detare në bregdetin shqiptar. Të gjitha këto shkonin në dëm të interesave të Turqisë. Italia, edhe përkundër dëshirës së Turqisë edhe më tutje përforconte pozitat e veta në Shqipëri e që ishte një rrezik përmanent.⁷

Italia, përveç që prekte interesat turke në Ballkan, në vitin 1911 ra në konflikt me Turqinë edhe për shkak të synimeve ndaj Libisë. Sulmi italian në Libi, sa e tronditi Turqinë po aq e dobësoi intensitetin e saj në Ballkan e posaçërisht në Shqipëri, ndaj se cilës shfaqte interes të posaçëm.⁸ Italia në vitin 1909, kishte qëndrim më të ashpër ndaj Turqisë, Ballkanit dhe Shqipërisë. Ajo nuk llogariste shumë rreth statuskuos.⁹ Fuqitë e mëdha kishin caktuar kriter se, cila do qoftë nga shtetet që prish gjendjen e statuskuos përkatësisht nëse sulmon ndonjë vend Ballkanik e në veçanti Sanxhakun ose Shqipërinë, do të duhej të paguante një kompensim material, si dënim i caktuar nga fuqitë e mëdha, pjesëmarrëse të më hershme të Kongresit të Berlinit.

Italia që nga viti 1908, kishte shfaqur aspirata serioze ndaj tokave të banuara me shqiptarë dhe nuk i interesonte çështja e kompensimit material, por as ndërhyrja eventuale e Austrisë apo Serbisë në Sanxhak e as aneksimi i Bosnës dhe Hercegovinës nga Austro-Hungaria. Ndaj këtyre sulmeve eventuale Italia ishte përcaktuar si vijon: nëse Serbia apo Mali i Zi e sulmojnë Sanxhakun, ajo nuk do të kërkojë kompensim material, për arsye se kishte pretendime ndaj territoreve shqiptare. Sipas një raporti të 21 tetorit të vitit 1908, Italia jo vetëm ndaj Serbisë dhe Malit të Zi, por qëndrim të ngjajshëm do të mbante edhe ndaj çdo shteti tjetër, sepse prapa këtyre qëndrimeve fshiheshin interesat më të mëdha të saj, përkatësisht ajo në këtë mënyrë rrezikonte interesat turke në Shqipëri. Këtyre makinacioneve diplomatike të Italisë, Turqia u kundërvihet me diplomaci.

Ministri i punëve të jashtme i Italisë Titoni, për t'u arsyetuar botërisht informon qeveritë ballkanike dhe evropiane se rrespekton deklaratën që të mos kërkojë kompensim material për sulme eventuale të ndonjë shteti kundër kujtdo qoftë në Ballkan. Italia kështu i siguronte vedit të drejtën që ta sulmonte Shqipërinë dhe të lirohet nga përgjegjësia

6A.SANDONA, L'iridentismo mello lotte politiche e nelle contese diplomatiche italo-austriace, vol.1. Bologna 1932,p.136

7V.P.Potemkin, Istorija Diplomatiye, izdanje arhiva za pravne i društvene nauke, Beograd, 1949, str.172

8Po ary

9Pino Rene, L'europeen et jeune Turqie, Paris 1913, p.341-343

duke konsideruar këtë si të drejtë të saj. Shqipëria tani gjendej para një rreziku serioz jo vetëm të pr etendimeve pushtuese italiane por edhe të Austro-Hungarisë dhe të Serbisë, sepse këto të fundit konsideronin se së shpejti do të përmysej qeveria e Xhonturqëve dhe kështu do t'i ndanin të gjitha territoret turke në Ballkan. Sidoqoftë, Italia me pretendimet e veta gjithnjë e më të hapta ndaj Shqipërisë i thellonte kontradiktat me qeverinë e Xhonturqëve.¹⁰ Bile ambasada turke në Romë, kishte marr një urdhëresë që ta informojë qeverinë turke se sjelljet e qarqeve të xhonturqëve ndaj shqiptarëve duhet të jenë më korrekte dhe më humane.¹¹ Konfliktet midis Turqisë dhe Italisë u shtuan edhe më shumë gjatë vitit 1908. Ajo zhvillonte propagandë duke trilluar teori mbi lidhjet historike, gjeografike dhe gjenezën e lashtë e të përbashkët me s hqiptarët. Kështu Italia rezervonte të drejtën për një përkujdesje dhe mbrojtje më të madhe ndaj tokave dhe popullatës shqiptare.¹² Këto ishin shkaqe dhe arsye që marrëdhëniet ndërmjet diplomacisë aktive italiane dhe qeverisë turke të acarohen edhe më shumë.¹³ Situatën në qeverinë turke e ndërlikonte edhe ushtria shqiptare në armatën turke pjesëtarët e së cilës nisën të dezertojnë për shkak të mospërbushjes së kërkesave nga marrëveshja me Xhonturqit (1908) rreth bashkëluftimit për përmbysjen e Perandorisë Osmane dhe të drejtave që ajo ua kishte premtuar shqiptarëve.

Që t'ia arrijë qëllimeve, Turqia nisë të futë përçarje midis shqiptarëve. Kështu në Kongresin e Dibrës që u mbajt më 23 korrik 1909 ia doli që t'i bëjë për vedi disa filoturq dhe kështu krijoi plasaritje të mëdha në lëvizjen për çlirim.¹⁴ Jeta e vështir nën turqit dhe aspiratat italiane në njerën. e në anën tjetër synimet e Austro-Hungarisë për tu bërë zotruese e tokave shqiptare krijuan kushte të rënda për shqiptarët. Italia për të bërë presion mbi Turqinë e akuzonte atë për padrejtësi fetare ndaj shqiptarëve të besimit katolik dhe apelon te qeveria turke dhe te fuqitë e mëdha. që ta de tyronin qeverinë xhonturke të garantonte respektimin e të drejtave fetare edhe për shqiptarët e konfesionit katolik. Këtë kërkesë e pranoi dhe e nënshkroi i ngarkuari i qeverisë turke për çështje fetare Valadin Efendiu. Ai u zotua se këtë normë fetare dhe sh pirtrore do ta respektojë me të drejtë të barabartë si për shqiptarët e besimit musliman ashtu edhe për ata të besimit katolik.¹⁵ Italia duke u thirrë

10 Haus-Hoff und Staatcharsivch politichen, Wien, PA.XII.K.0203, gusht. 1908

11 Po ary

12 Po ary

13 Po ary

14 Haus-Hoff und Staatsarchis politiches "P". Wien, PA-XII-K-0203, gusht 1908

15 Po ary

në mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve të besimit katolik, në prill të vitit 1909, në formë demonstrative aktivizoi flotën e vet, në ujrat detare turke, në shenjë kërcënimi, po qe se edhe shqiptarët e besimit katolik nuk do t'i gëzonin të drejtat e barabarta fetare, sikur edhe ata të besimit musliman, do të intervenonte edhe në Detin Marmara. Qeveria e Xhonturqëve iu kundërvu me të gjitha mjetet dhe format diplomatike, por Italia më në fund e siguroi praninë e saj në ujrat turke, duke hapur posta të ashtuquajtura detare, apo përfaqësi italiane në portet shqiptare e turke. Këto ishin mundësi të mira për ndërhyrjen italiane në çështjet shqiptare dhe turke.¹⁶

Italia e vetmuar nuk kishte potencial teknik e ushtarak për ta pushtuar Turqinë, ndaj i shfrytëzoi dy mundësi për të ndërhyrë në detra: gjendjen e rëndë ekonomike në të cilën gjendej Turqia dhe plasaritjet e brendshme e kërcënimet që vinin nga jashtë. Turqija e kishte të qartë se në rast konflikti, Italisë do t'i ndihmonin shtetet evropere dhe kështu humbja e saj do të ishte e sigurt.¹⁷ Italia nëpërmjet konsulit të vet në Shkodër, në formë të prerë, kërkoi nga Turqia që ta rregullojë gjendjen ekonomike në Kazanë e Vlorës, në Sanxhakun e Durrësit, në Vilajetin e Shkodrës dhe në disa vende të tjera të Shqipërisë, gjoja të mos rrezikohen interesat e popullatës shqiptare. Italia vepronte kështu duke u arsyetuar se kishte dhënë ndihmë komerciale për forcimin e ekonomisë shqiptare.¹⁸ Krahas organizimit dhe zhvillimit të lëvizjes kombëtare shqiptare kundër pushtuesit turk gjatë viteve 1910-1911 edhe qeveria italiane gjenë forma të reja për t'iu kundërvënë regjimit turk. Këtë e bënte gjoja në shenjë solidariteti dhe të perzierjes së Turqisë në çështjet e brendshme të shqiptarëve. Atëbotë në Itali ishte formuar organizata "Proalbania", e përbërë nga arbëreshë dhe italianë si dhe "Komiteti italo-shqiptar". Që të dyja ishin aktive rreth çështjes shqiptare dhe çlirimit nga Turqia. Duke i organizuar garibaldianët për ndihmë shqiptarëve, të armatosur i binte në Shqipëri që të merrnin pjesë në kryengritjet e Vilajetit të Shkodrës dhe të Kosovës. Në lëvizjen për përkrahjen e kryengritjeve shqiptare në mënyrë të veçant u dalluar "Proalbania". Në të ishin inkuadruar edhe pjestarë nga qarqet borgjeze dhe imperialiste italiane. "Proalbania" ishte në bashkëpunim me repartet garibaldine, nën udhëheqjen e Ricciotti Garibaldinit. Këto qarqe dhe organizata, në krye me Komitetin italo-shqiptar prinin me parullën "Shqipëria e shqiptarëve". Në të vërtetë kjo ishte mënyra më e mirë e

¹⁶Hrvatsko pravi, gazetë kroate, nr.3727, Prill, 1909

¹⁷Po aty

¹⁸Archivio Segretogenerale (1908-1913), pocco 35 P.2. pozicion del 447-449 et cacela 60. fasc. 1142, Posiz. XX.17/17 Roma, Doc dërguar nga Shkodra në Romë, me 16.VII.1909

dominimit të tyre në një pjesë të shqiptarëve të besimit katolik.¹⁹ Kryeministri i qeverisë italiane San Gjuliano, këtë ndihmë kryengritësve shqiptarë e konsideronte si obligim të domosdoshëm dhe shumë të nevojshëm, ndaj nuk përfill konfrontimin me qeverinë e xhonturqëve.²⁰ Italia rreth kësaj çështjeje pos që kishte një kurs të veçant politik, për këtë qëllim kishte ndarë edhe mjete të posaçme materiale.²¹ Qeveria e Sangjulianos e informon qeverinë turke se poqë se kryengritjet shqiptare nuk pushojnë Italia ka obligim t'i ndihmoj kryengritjet shqiptare, sepse rrezikohen interesat e saj.²² Analitikët e politikës aktuale italiane, rreth çështjes shqiptare na mësojnë se qeveria e Austro-Hungarisë, Serbisë dhe e Malit të Zi bënë përgaditje aktive që t'i sulmonin tokat shqiptarëve nëse kryengritjet e tyre kundër pushtuesit turk nuk do t'ia dilnin ta çlironin Shqipërinë. Haki Pasha, edhe pse rrethanat i sheh mjaft të ndërlikuara, për t'i zbeh apetitet pushtuese të shteteve ballkanike dhe të Austro-Hungarisë, ai e vlerëson si të pabazë konstatimin e qeverisë italiane për rrezikun që i kanosej shqipërisë nga jashtë. Pa marrë parasysh kombinimet që bëheshin rreth çështjes shqiptare Italia u deklarua se poqë se Turqia nuk i respekton kërkesat e shqiptarëve, aty do të zhvillohen kryengritje me dimensione më të mëdha me pjesëmarrjen e Italisë.²³

Borgjezia italiane, ar bërëshët e Italisë dhe disa shqiptarë të besimit katolik i kishte vënë nën ndikimin e saj dhe i shfrytëzonte për bashkëpunim më të ngjeshur me qeverinë e Italisë. Duke ua bërë me dije se janë të rrezikuar i fton që të jenë të arsyeshëm, kurse qeveria italiane zotohet se do t'u dalë në ndihmë në çdo aspekt e po që nevoja edhe me luftë. Kështu më 27 prill 1911, Terenc Tochi në bashkëpunim me bajraktarë të Malsisë së Lezhës dhe të Mirditës e shpalli pavarësinë e përkohëshme të Shqipërisë. Turqia, nën ndikimin e Austrohungarisë u detyrua të ndërmarrë masa për t'i qetsuar shqiptarët, në mënyrë që kryengritja të mos marrë dimensione të mëdha. Duke e vlerësuar këtë çështje si shumë të nevojshme vetë sulltan Mehmed Reshadi i pestë, më 16 qershor 1911 erdhi në Prishtinë dhe shpalli amnistinë e të burgosurve, pjesëmarrës në kryengritjen e vitit 1911. Përveç këtij, në këtë vazhde edhe Shefqet Turgut Pasha më 17 qershor do t'i amnestonte të gjithë kryengritësit të cilët dorzohen në afat prej dhjetë ditësh. Këto

¹⁹Historia e popullit shqiptar, vëllimi II, f.30

²⁰Carado Barbagalli. Cento ani di vita italiano volume I. archivio centrale italiano, Roma

²¹Arkivi shtetror i Serbisë në Beograd-konsulata serbe në Prishtinë Informatë e dërguar nga Prishtina në Beograd, më 22 maj 1911

²²Haus-Hoff und staatsarchiv politiches, Wien PA.XII-K.0204,raport nga Stambolli dërguar në Budapest, shkurt 1911

²³Po aty. Raport i dërguar nga Stambolli në Shkup në Shkurt 1911

amnisti u bënë për shkak të kërcënimit të Italisë se do t'i ndihmojë kryengritësit shqiptarë. Turqia këtë lojë politike të Italisë e sheh si shumë të rrezikshme, jo vetëm për Shqipërinë e Ballkanin, por edhe më gjerë, prandaj provon edhe forma të tjera të kompromisit me shqiptarët.²⁴ Përkundër përpjekjeve dhe pretendimeve italiane që ta dobësojë Turqinë në Ballkan e sidomos në tokat shqiptare, Turqia provon t'i nxisë shqiptarët në luftë kundër Italisë. Kjo edhe ishte rruga më adapte që ta largojë rreziku nga sulmet eventuale ndaj saj. Ky plan jo vetëm që deshtoi por i acaroi edhe më shumë marrdhënjet edhe ashtu të tendosura midis Italisë dhe Turqisë.²⁵ Meqenëse interesat dhe konfrontimet e këtyre dy shteteve ishin të ndërlydhura në Shqipëri dhe në Libi ato angazhonin dhe venin në funksion si potencialet e tyre diplomatike ashtu edhe ushtarake. Italia për ta shtuar praninë e vet në Shqipëri, stimulon moralisht dhe materialisht kryengritjet shqiptare kundër pushtuesit turk por njëherazi dërgon mësheftas edhe personelin ushtarak (Garibaldin) dhe ndonjë përcjellës të ngjarjeve në rolin e vëzhguesve.²⁶ Deri sa Italia nuk ishte e zënë në konflikt me Turqinë për çështjen e Libisë i ndihmoi kryengritjet shqiptare në luftë kundër Turqisë duke u dhënë përkrahje në aspektin fetar ë, ekonomik dhe politik. KUr ajo në shtator të vitit 1911, i shpalli luftë Turqisë për shkak të pushtimit të Libisë, e la anash çështjen shqiptare, madje sikur të mos ishte bërë fjalë kurrë për të. Italia veproi në këtë mënyrë për të mos e zgjuar kureshtjen e të tjerëve në lidhje me këtë çështje të perseritur shumë herë më parë.²⁷ Ajo përveç që e sulmoi Libinë, në Ballkan organizon shërbimin e vet propagandues në mënyrë që sa më shumë ta destabilizojë Turqinë në aspektin politik.²⁸

Kur shqiptarët shpallën pavarësinë e tyre, Ismail Qemali iu drejtua shumë shteteve evropiane për ta njohur Shqipërinë. Përkundër që disa shtete evropiane dhe ballkanike patën qëndrim mohues, Italia pos që e pranoi, i dha asaj edhe përkrahje morale e historike.

Çështja shqiptare që nga fillimi i Luftës së Parë Ballkanike nuk mvarej vetëm nga zhvillimi i luftës së tyre por edhe nga rrjedha dhe përfundimi i saj. Sipas Leninit "Lufta e Parë Ballkanike është një nga hallkat, në zinxhirin e ngjarjeve botërore, që shënon shembjen e mesjetës në Evropë dhe Azinë Juglindore, krijimin e shteteve të bashkuara

24Haus Hoff und Staatsarchiv politichs, Wien PA.XII-K-0204, raport i dërguar nga Stambolli në Shkup në shkurt të v.1911

25Po aty dhe Historia e popullit shqiptar, vëll.II.f.308

26Haus Hoff und Staat sarchives, Wien PA-XII. Albanie XXXIV

27Si shen.nr.179. f.344

28Po aty

kombëtare në Ballkan, përmbysjen e robërisë së feudalëve, çlirimin përfundimtar të fshatarëve ballkanas të çdo kombësie nga zgjedha e çifligarëve. Kjo ka qenë detyrë historike që qëndronte para popujve të Ballkanit". Ky konstatim i Leninit e ka bazën e vet shkencore²⁹. Por shikuar nga aspekti i aleancës së shteteve borgjeze të Ballkanit në të cilat caktoheshin sferat e tyre të interesit në dëm të të tjerëve: shqiptarëve dhe maqedonëve, nuk qëndron dhe nuk është i pranueshëm sepse dalin në shesh aspiratat pushtuese të shteteve të aleancës ballkanike.³⁰

Prej vitit 1908 e deri më 1913 çështja shqiptare ishte kryesisht e rrezikuar nga Italia dhe Austrohungaria sepse si njëra ashtu edhe tjetra shfaqnin interesat e veta mbi tokat shqiptare duke i dhënë vedit të drejtë që këtë popull ta konsideronin si objekt të interesave të tyre. Sherbimi sekret italian me vemendje përcillte luftën e Malit të Zi për pushtimin e Shkodrës e kurdisur nga qeveria e Esad Pashë Toptanit dhe qeveria malazeze. Për t'u informuar drejt dhe më për së afërmi Italia kishte dërguar në Shqipëri fshehurazi emisarin e vet (një kolonel). Edhe ky fakt flet për zgjerimin e interesave të Italisë në Shqipëri.

Dr Islam Dobra

CONFLICTS BETWEEN ITALY AND TURKEY ON THE ALBANIAN PROBLEM

Summary

Italy had many political and diplomatic conflicts with Turkey about the Albanian question between 1908 and 1913. They sometimes took proportions that threatened to armed war. Italy did not save itself to create the environment for Albania to become a sphere of its influence. The analysts of the time, of Italian diplomacy, evaluated that the Turkish occupier did not have a long life in the Balkans. Due to this, Italy besides offering the Albanian uprisings moral and political aid, it did not hesitate to offer them material aid with arms, funds and human potential (garibaldins). It came to conflict with Turkey about the Albanian question because it considered it as one of its own matters. Italy did all of this for a certain intention: as soon as Turkey would leave the Balkans, it could put Albania under its control.

²⁹По аты

³⁰Albania Apice. SPA, Industria tipografica. Roma, 1962. p.251-156

